



Në pajtim me nenin 18 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216 (i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 15 të Ligjit Nr: 04/L-133), Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK), më datë **25.09.2023**, publikon si më poshtë:

Shpallje për pozitën:

Anëtar jo-ekzekutiv i Bordit Menaxhues të FSDK-së, ekspert, me përvojë në fushën e sigurimit të depozitave dhe financave, me mandat pesë vjeçar

Profili i kërkuar:

- I/E njohur për standard të lartë të integritetit dhe reputacionit;
- Arsimim të lartë profesional në çështje financiare, bankare apo ligjore;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale në fushën e financave, bankave apo ligjore;
- Minimum pesë (5) vite përvojë profesionale në fushën e sigurimit të depozitave dhe financave;
- Pa asnjë mandat politik, aktualisht apo në vitin paraprak;
- Gjatë vitit paraprak pa histori punësimi apo angazhimi si drejtues ose anëtar i Bordit Drejtues në ndonjë institucion financiar që pranon depozita në Kosovë, anëtar të FSDK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojë kriteret e përshtatshmërisë sipas nenit 20, paragrafët 1.1-1.4 Ligji Nr: 03/L-216
- Përvojë në zbatimin e Direktivës Evropiane mbi sigurimin e depozitave, e preferuar;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera paraqet përparësi

Përgjegjësitë si anëtar i Bordit do të përfshijnë përgjegjësitë e përcaktuara me Nenin 19 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216 (i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 16 të Ligjit Nr: 04/L-133):

- Emërimin e Drejtorit Menaxhues të FSDK-së
- Lidhjen e kontratave dhe të jetë palë në procedura ligjore
- Marrjen, mbajtjen dhe heqjen dorë nga prona e FSDK-së
- Miratimin e të gjitha rregullave, urdhërësive dhe udhëzimeve për menaxhimin dhe operimin e FSDK-së
- Miratimin e planit financiar dhe pasqyrat financiare të FSDK-së
- Miratimin e Politikës për investime të FSDK-së
- Marrjen e vendimeve për ndryshimin e nivelit të premuimeve të sigurimit
- Rekomandoj ndryshime në Ligjin për Sigurimin e Depozitave
- Plotëson kushtin për pjesëmarrje në takim të Bordit sipas nenit 21, paragrafi 7 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216
- Miratimin e emërimit të auditorit të jashtëm të FSDK-së
- Miratimin e metodave të pagesave për kompensim të depozitorëve në ngjarje të siguruar apo miratimin e shfrytëzimit të fondeve lidhur me bartjen e detyrimeve në proces të zgjidhjes së ndonjë banke
- Vlerësimin e dënimeve dhe zbatimin e masave detyruese
- Miratimin e huazimeve për FSDK-në
- Miratimin e numrit të personelit të FSDK-së

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet në vijim:

1. CV të detajuar.
2. Letrën motivuese ku theksohet interesimi për pozitën.
3. Diplomën universitare dhe certifikatat tjera relevante (kopje);
4. Formularin “Deklaratë nën betim” të plotësuar dhe nënshkruar (i qasshëm në linkun www.fsdk.org/sq/njoftimet/konkurse-pune).

Si të aplikoni:

- Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë kalendarike nga data **25.09.2023 deri me 09.10.2023 ora 16:00**.
- Mund të aplikoni përmes postës elektronike në adresën: **FSDKkomisioni@fsdk.org** ose të dorëzoni fizikisht dosjen tuaj në adresën e FSDK-së: Rr. Bekim Fehmiu, nr.31, kati i I-rë, Lakërishtë , 10 000 Prishtinë.

Aplikacionet e pa kompletuara me 4 dokumentacionet e lartpërmendura nuk do të merren parasysh nga komisioni. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen për intervistë.